

HYGO – Katedralja e Parisit

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Si u kundërvihet Hygoi letërsisë klasikiste dhe parimeve të saj me romantizmin e vet?

Pse letërsia e krijuar nga Hygoi është në përgjithësi letërsi e kontrasteve?

Tregoni disa nga kontrastet tipike romantike të romanit “Katedralja e Parisit”.

Në ç’vetë është ndërtuar rrëfimi në këtë roman? Ç’raport krijon autori me personazhet përmes një rrëfimi të tillë?

Fragmenti “Esmeralda”

Cili ishte arti i mesjetës dhe ç’lidhje kishte ai me pasqyrimin e jetës së përditshme? Ilustroni mendimin me pjesë nga fragmenti “Esmeralda”.

Si mendoni, pse njerëzit pëlqenin më shumë karnavalet, sesa një pjesë teatrore?

-shënime-

Gjeni pjesë në tekst për të ilustruar ironinë e përdorur kur flitet për pjesën teatrale.

A del Esmeralda në skenë në këtë fragment? Pse?

Gjeni përshkallëzimin në paraqitjen e Esmeraldës në fragment.

Pse dalja e Jupiterit në skenë ndodh në të njëjtën kohë me shfaqjen e Esmeraldës në publik?

Gjeni antitezat bazë mbi të cilat ndërtohen kontrastet e fragmentit (tipar i romantikëve).

Fragmenti "Shtylla e turpit"

Cili është qëndrimi i Hygoit ndaj sistemit të drejtësisë të asaj kohe? Ilustrojeni mendimin me shembuj nga teksti.

-shënime-

Komentoni qëndrimin e Hygoit ndaj sistemit të drejtësisë duke u bazuar në fjalët:

...ai po ndëshkohej vetëm ngaqë kishte pasur fatkeqësinë të gjykohej prej një shurdhi, duke qenë edhe vetë shurdh.

Bashkëshoqërohet civilizimi i kësaj shoqërie me sistemin e drejtësisë apo bën kontrast?

Ai ishte shumë larg shoqërisë njerëzore dhe shumë afër gjendjes primitive, prandaj nuk dinte ç'është turpi.

Kuazimodoja përshkruhet më afër kafshës, sesa njeriut. Gjeni fajtorin për këtë gjendje të tij.

Në krye ai u mbajt i fortë. Por pak nga pak durimi i tij filloi të binte dhe nuk u bëri dot ballë atyre pickimeve prej mushkonje.

Ç'tregon ky reagim i Kuazimodos ndaj talljeve të turmës?

Çfarë ndikimi ka në gjendjen e Kuazimodos ikja e Froloit?

Analizoni antitezën e çiftit Frolo – Esmeralda.

Ç'tregon fakti që Froloi u kthye dhe iku, ndërkohë që Esmeralda arriti ta prekte gjithë turmën?

-shënime-

Gjeni dhe analizoni tipare të romantizmit të Hygoit në fragment.

*Kthesat e befasishme:**Antitezat:**Hiperbolat:*

Ese:

E bukura është e shëmtuar kur është vetëm e jashtme.